



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni pranveror

Seanca plenare e Kuvendit
P- 105
Prishtinë, më 18 mars 2010

PROCESVERBAL

I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 18 MARS 2010

Seancën e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit, ndërsa i ndihmoi **Ibrahim GASHI**, anëtar i Kryesisë së Kuvendit.

Kryetari konstatoi se në sallë janë të pranishëm 63 deputetë.

Në fillim të seancës, kryetari njoftoi deputetët për zëvendësimin e deputetit. Nga radha e PDK-së, në vend të ish-deputetit Hashim Thaçi, është caktuar Abdyl Ymeri, të cilit i dëshiroi mirëseardhje dhe punë të mbarë në Kuvend.

Kryetari propozoi që koha e diskutimeve për kryetarë të grupeve parlamentare të jetë 10 minuta, ndërsa për deputetë 5 minuta. Ai hodhi në votim këtë propozim. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----41,
Kundër-----15,
Abstenime----- 2.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, miratoi propozimin që koha për diskutim për kryetarët e grupeve parlamentare të jetë 10 minuta, ndërsa për deputetët nga 5 minuta.

Kuvendi, në vazhdim i zhvilloi punimet me këtë pikë të rendit të ditës:

1. Shqyrtimi i Propozim – Strategjisë së energjisë për periudhën 2009-2018

Kryetari ftoi përfaqësuesin e qeverisë së Kosovës për ta arsyetuar Strategjinë e energjisë për periudhën 2009-2018 para deputetëve të Kuvendit.

Ministrja **Justina Shiroka-Pula** tha se Ministria e Energjisë dhe e Minierave, në bashkëpunim me Zyrën e Rregullatorit të Energjisë, KOSTT-in, KEK-un, Ngrohoret e qytetit, Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave dhe Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, në përputhje me kërkesat e Ligjit për energjinë elektrike 2004/8, gjatë vitit 2009 ka rishikuar Strategjinë e energjisë 2005 – 2015, dhe bazuar në atë, ka përgatitur Strategjinë e energjisë për periudhën 2009 – 2018.

Kjo strategji bazohet në Programin e Qeverisë për sektorin e energjisë, si dhe në platformën e politikës energjetike të Kosovës.

Strategjia e energjisë 2009 – 2018, i kushton vëmendje të veçantë përputhshmërisë me *acquis communautaire* të Bashkimit Evropianë, që për sektorin e energjisë janë të obligueshme për Kosovën në kuadër të anëtarësisë në Traktatin e komunitetit të energjisë.

Strategjia synon: stimulimin, përdorimin racional të energjisë dhe rritjen e eficiencës së përdorimit të saj, shfrytëzimin e burimeve të ripërtëritshme të energjisë, futjen e teknologjive të reja dhe zbatimin e standardeve mjedisore, siç ato parashikohen me ligj.

Strategjia është e ndarë në dy pjesë: **Pjesa e parë**, përmban një paraqitje komplete dhe analizë të situatës aktuale dhe të progresit të arritur në sektorin energjetik gjatë periudhës 2006 – 2008, përfshirë politikat e zbatuara deri më tani, kuadrin ekzistues ligjor dhe rregullator, institucionet dhe ndërmarrjet ekzistuese energjetike, analizën e konsumit, të prodhimit, bartjen dhe shpërndarjen e furnizimit të energjisë, progresin në sektorin e ngrohjes, gazit natyror, eficiencës së energjisë dhe të burimeve të ripërtëritshme, mbështetjen financiare publike edhe nga donatorët për sektorin energjetik, si dhe progresin e arritur në fushën e integriteteve rajonale dhe evropiane.

Pjesa e dytë përmban: parashikimin e nevojave për energji për periudhën 2009 – 2018, në total dhe për secilin sektor ekonomik, misionin dhe vizionin e strategjisë, objektivat strategjike, politikat dhe masat prioritare për realizimin e objektivave strategjike, perspektivën e integriteteve evropiane dhe bashkëpunimin ndërkombëtar, nevojën dhe masat për ngritjen e kapaciteteve institucionale vendore dhe masat e parashikuara për zbatimin e kësaj strategjie.

Strategjia synon përgatitjen e një kuadri të plotë ligjor dhe rregullator, që do të mundësojë tërheqjen e investimeve të konsiderueshme private në sektorin energjetik.

Po jap disa sqarime lidhur me rekomandimet e këshilltarëve të transaksionit të projektit - Termocentrali “Kosova e Re” për rekomandimet e komisionit funksional parlamentar:

1) A do të përfshihet apo jo Termocentrali “Kosova B” në paketën e Termocentralit të Ri? Në Strategjinë e energjisë 2009 – 2018, parashihet rivitalizimi i Termocentralit “Kosova B” me investime private, kur këtij termocentrali t’i vjen koha, pasi që të futen

në operim blloku i parë i Termocentralit “Kosova e Re”, pra aty rreth vitit 2016. Kjo bazohet në atë që kryeministri, me mbështetjen e Bankës Botërore dhe të Departamentit të Shtetit të Amerikës dhe përkrahjen e Komisionit Evropian e të partnerëve tjerë ndërkombëtarë e paraqiti si politikë më të re energjetike, më 15 korrik 2009.

B) Ne, si komitet dhe si drejtues të projektit dhe bashkë me ne edhe Qeveria, jemi dakorduar me kërkesën e këshilltarëve të transaksionit që të marrim në konsiderim opsionin e futjes së Termocentralit “B” në Termocentralin “Kosova e Re” për të parë se me sa leverdi mund të jetë ky opsion.

Pyetja e dytë – Kapacitetet e Termocentralit “Kosova e Re”, parashikimet janë që deri në vitin 2025 Kosovës do t’i duheshin rreth 2000 megavat të instaluara. Prandaj, edhe në strategji kemi parashikuar që të ndërtojmë 2000 megavat në periudhën afatgjatë dhe mundësinë për të shfrytëzuar të gjithë Sibovcin, por deri në vitin 2018, për periudhën që mbulohet nga kjo strategji, na duhen aty rreth 1000 megavat.

Komisioni i Kuvendit rekomandon që lokacioni për ndërtimin e Termocentralit “Kosova e Re” të jetë ai pranë Termocentralit “A”. Në Strategjinë e energjisë 2009 – 2018 nuk definohen lokacioni, sepse mendojmë se kjo është një çështje më shumë teknike, ekonomike dhe për negociata për investitorë.

Preferohet që “Kosova e Re” të ndërtohet në lokacionin pranë “Kosovës B”, sepse sipas analizave të kryera në kohën e fundit, ky lokacion ofron zgjidhje më të lirë, më të shpejtë dhe më të realizueshme.

Në fund, ministria Pula i ftoi deputetët e Kuvendit ta miratojnë, në parim, Strategjinë e energjisë 2009 – 2018.

Pas arsytimit të ministres, kryetari hapi debatin parlamentar për Propozim- Strategjinë e energjisë 2009 – 2018.

Deputetja **Myzejane Selmani**, në emër të komisionit funksional tha se kanë shqyrtuar Propozim- Strategjinë e energjisë 2009 – 2018 dhe e mbështet, në parim. Komisioni i rekomandon Kuvendit që Termocentrali “Kosova B” të mos përfshihet në pakon e tenderimit të privatizimit të Termocentralit “Kosova e Re”.

Termocentrali “Kosova e Re” mundësisht të ndërtohet në lokacionin e Termocentralit “Kosova A”, dhe ndërtimi i kapacitetit gjenerues të Termocentralit “Kosova e Re” të bëhet në bazë të bilancit energjetik që ka Kosova që, sipas tij, për fazën e parë parashihen nevojat e kapaciteteve prej 1000 megavatesh.

Deputetja **Sala Berisha – Shala**, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së tha se e kanë shqyrtuar me vëmendje Strategjinë e energjisë së Republikës së Kosovës për periudhën 2009 – 2018 dhe e mbështesin, në parim.

Ministria e Energjisë dhe e Minierave në dokumentin e saj për Strategjinë e zhvillimit të sektorit të energjisë në Kosovë, pos tjerash i paraqet dhe i parasheh ndërrimet ligjore, organizative, institucionale, pronësore dhe ekonomike dhe të tjera në këtë fushë shumë të rëndësishme.

Parashikimi i prodhimit të energjisë për vitin 2009 – 2018 është një paraqitje reale. Duke analizuar tabelat, shohim se Kosova ka nevojë për import deri më 2015.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, pas analizimit të këtij dokumenti shumë të rëndësishëm i rekomandon Qeverisë që të marrë masa për themelimin dhe funksionalizimin sa më të shpejtë të Korporatës së linjitit, për këto arsye:

1. Të realizohet pronësia e Kosovës ndaj burimeve të linjitit, me mundësi për dhënie të një pjese të aksioneve, sipas nevojës, për investime private.
2. Korporata do të furnizojë me linjit kapacitetet ekzistuese të Termocentralit “Kosova A” dhe të Termocentralit “Kosova B”, si dhe blloqet e Termocentralit “Kosova e Re”.

Deputeti **Fatmir Rexhepi**, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, tha se objektivat kryesore dhe synimet strategjike në fushën e energjisë për Kosovën, janë plotësisht të arsyeshme dhe kanë të bëjnë edhe me promovimin e resurseve dhe të potencialit energjetik që ka vendi ynë.

Krijimi i tregut energjetik dhe i konkurrencës është pjesë e këtij drafti. Mendoj se rol të veçantë ka sektori privat dhe se është në harmoni të plotë me politikat që duhet t’i ketë një vend për sektorin energjetik.

Prandaj, këtu duhet të shikohet strategjia lidhur me ndërtimin dhe investimet e reja në fushën e energjetikës, në mënyrë që të kemi pastaj edhe një ndikim apo impakt të drejtpërdrejtë në zhvillimin ekonomik të vendit, sepse ne e kemi një potencial, një resurs-thëngjillin, që realisht është ndër resurset kryesor në të cilat duhet të bazohet zhvillimi ekonomik. Nuk e di sa tani kjo qëndron në harmoni me këtë strategji.

Qëndrimi i Grupit Parlamentar të LDK-së sa u përket rekomandimeve dhe plotësimeve tona në fund të debatit, është që Qeveria duhet t’i zbatojë ligjet dhe strategjinë për energjinë, të mos veprojë jashtë strategjisë për energji. Pra, asnjë plan i veprimit aktual që del jashtë kësaj strategjie, nuk duhet të jetë pjesë e aktiviteteve të mëtutjeshme. “Kosova B” të mos jetë pjesë e paketës “Kosova e Re”, si dhe “Kosova e Re” të jetë 1000 plus 1000, pra 2000 megavat qysh është në strategji deri në vitin 2018, dhe më vonë 1000 megavat të tjera, për të qenë, pra, konkurrent dhe për t’i përmbushur ato kërkesa, ato analiza energjetike që i duhen zhvillimit ekonomik të vendit.

Ne e përkrahim, në parim, Strategjinë e energjisë së Republikës së Kosovës për periudhën 2009 – 2018, por ajo duhet të plotësohet në bazë të debatit të sotëm dhe Qeveria, më pastaj, ta bëjë planin e veprimit në pajtim me këtë strategji.

Deputeti **Ethem Çeku**, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, tha se Strategjia e energjisë, që sot po e diskutojmë, determinon të ardhmen ekonomike të Kosovës dhe të qytetarëve tanë. Qeveria e tanishme nuk po tregon aftësi për t’i përdorur resurset natyrore për zhvillim ekonomik.

Largimi po thuhet se i tërë konzorciumeve më të rëndësishme botërore që kishin konkurruar për projektin “Kosova C”, është mesazhi më i keq për zhvillimin ekonomik të Kosovës pas përfundimit të luftës.

Politikat e kësaj Qeverie, të këtij Komiteti drejtues dhe të një pjese të këshilltarëve ndërkombëtarë, po bëjnë që e ardhmja e vendit tonë të jetë me plotë pikëpyetje.

Strategjia e prezantuar sot është dokument i vjetër që nuk i përgjigjet realitetit kohor.

Kjo strategji nuk është në harmoni me politikat e ndjekura nga Komiteti drejtues i projektit “Kosova e Re”. Në këtë strategji planifikohet që kapacitetet e reja të ndërtohen në dy faza: 1000 plus 1000 megavat. Komiteti drejtues ndjek politika në ndërtimin e kapaciteteve 500 megavat, me mundësi të ndërtimit edhe të 500 megavateve të tjerë më vonë.

Strategjia nuk është në harmoni me bilancin energjetik të Kosovës dhe parashikimet e kërkesave për energji në vitet e ardhshme.

Prandaj, edhe një herë e ftoj Parlamentin, institucionet, Qeverinë, që të bëjnë harmonizimin e strategjisë me projektin. Nuk mund të ecën strategjia në raporte të ndryshme me projektin.

Deputetja **Myzejene Selmani**, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, kërkoi sqarime nga propozuesi i Strategjisë për energjinë, si në vijim:

1. Pse është vonuar deri tash dhe kah po shkon ndërtimi i kapaciteteve të reja?
2. Pse po mungon transparenca për projektin e strategjisë së energjisë për Kosovën?
3. Pse nuk është paraqitur një raport i planit implementues për periudhën paraprake posa të fillohet me rishqyrtim të strategjisë së energjisë?

Kjo strategji duhet të ishte më transparente për arsye se janë duke shkuar dy projekte: projekti i termocentralit “Kosova e Re” dhe projekti i privatizimit të Distribucionit dhe Furnizimit.

Në vazhdim, deputetja Myzejene Selmani ia bëri një analizë Strategjisë së energjisë, që i është bashkangjitur transkriptit.

Qëndrimi i Grupit Parlamentar të AKR-së është se rekomandimet duhet të përfshihen në Strategjinë e energjisë dhe ky dokument strategjik të aplikohet për të mirën e qytetarëve të Kosovës.

Deputeti **Lulzim Zeneli**, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, tha se LDD vlerëson se ky dokument apo kjo strategji nuk merr për bazë interesin shtetëror të Kosovës. Kjo strategji është, në fakt, për humbjen e pasurisë së Kosovës dhe të resurseve të saja. Në këtë formë, shteti i Kosovës do të jetë qiraxhi pa pronësi në resurset e tij strategjike.

LDD vlerëson se vizioni i Strategjisë për zhvillimin e energjisë së vendit, e që ky dokument nuk e ka, do të duhej të ishte i orientuar në tri shtylla kryesore, dhe atë:

1. Definimi i interesit shtetëror të Kosovës.
2. Definimi i qartë i principeve të zhvillimit të qëndrueshëm të energjisë, që nënkupton realizimin e objektivave që obligon ekuilibri energji – mjedis.
3. Implementimi i kriterëve dhe standardeve të BE-së, me fokus të veçantë – uljen e misionëve karbonike.

LDD vlerëson se cilido hap që do të ndërmerret për kapacitetet aktuale energjetike, pa nxjerrjen e Ligjit për privatizimin e KEK-ut dhe pa një vlerësim real të aseteve, do të ishte një gabim i madh me pasoja të rënda.

Deputeti **Xhezair Murati**, tha se Grupit parlamentar “7+”, e ka analizuar Strategjinë energjetike dhe në parim duhet t’i përkrahim zgjidhjet e ofruara, por me një numër të konsiderueshëm të vërejtjeve që i konsiderojmë si të argumentuara. Ne kuptojmë se interesi kryesor i paraqitur në këtë analizë energjetike ,që bazohet në linjit, siç është parashikuar në strategji, është edhe burim themelor energjetik.

Mendoj se pa marrë parasysh resurset e volitshme kur bëhet fjalë për mihjet sipërfaqësore apo thellësinë e pamjaftueshme për shfrytëzimin e tyre, nuk mund të pajtohemi pse shumë pak flitet për hidropotencialin. Gjithashtu kemi të dhënat e pakta për hidrocentralin e planifikuar në Zhur. Shtrohet pyetja pse nuk fillohet nga pikëpamja se Kosova nuk është mjaft e pasur me ujërat sipërfaqësore?

Ne do ta përkrahim këtë strategji, por ajo duhet të plotësohet.

Deputetja **Vezira Emrush**, në emër të Grupit Parlamentar për Integritet tha se në këtë strategji është përshkruar, në qoftë se e kemi lexuar me kujdes, plani afatmesëm dhe afatgjatë i zhvillimit të këtij sistemi në Kosovë.

Megjithatë, ne kemi hasur në disa çështje që janë theksuar në këtë strategji. Kjo strategji është hartuar me qëllim të përmbushjes së dokumentit, por jo nevojave të Kosovës, sepse si dokument nuk përmban parametrat dhe destinimet kualitative, si dhe qëllimet për realizimin e kësaj strategjie.

Kur bëhet fjalë për kapacitetet e prodhimit të energjisë elektrike, janë përshkruar blloqet A dhe B, me fuqinë e përgjithshme të instaluar prej 1500 MW, që praktikisht janë të vjetruar, ndërsa kur bëhet fjalë për energji alternative, Qeveria nuk duhet të orientohe në kapacitete të mëdha, por duhet t’i shfrytëzojë resurset e ujit, erës dhe të diellit.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me Strategjinë e energjisë për periudhën 2009-2018, dhanë këta deputetë: **Naim Rustemi, Driton Tali, Haset Cakolli, Naser Rugova, Riza Smaka, Nait Hasani, Sabri Hamiti, Emrush Xhemajli, Xhavit Haliti, Gani Geci, Bajram Kosumi, Armend Zemaj, Enis Kervan, Ardian Gjini, Berat Luzha, Gjylnaze Syla, Qamile Morina, Ibrahim Gashi, Berim Rsamosaj, Donika Kadaj-Bujupi, Jakup Krasniqi, Bahri Hyseni, Mark Krasniqi, Ibrahim Selmanaj dhe Zef Morina**, që janë dhënë në transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverbali.

Në fund të debatit, me propozimin e kryetarit, Kuvendi nxori këtë

P Ë R F U N D I M

1. Ngarkohet Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion që, në bazë të debatit të zhvilluar në seancën plenare, më 18 mars 2010 dhe në bashkëpunim me Qeverinë dhe me ekspertët vendorë dhe ndërkombëtarë të fushës së energjisë, t'i plotësojë rekomandimet për Strategjinë e energjisë për periudhën 2009-2018.
2. Rekomandimet e plotësuara duhet t'i paraqiten Kuvendit për miratim në afatin sa më të shpejtë të mundshëm.

Kryetari e deklaroi të mbyllur seancën plenare në orën 15:45 minuta.

Kryetari i Kuvendit,
Jakup KRASNIQI

Përgatiti: Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale